1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sçarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*)

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të posaçme të artikujve objekt prokurimi, referuar katalogut të unifikuar në fuqi “Blerje materialesh të ndryshme për pastrim dhe materiale të nevojshme për mbrotjen personale”, renditen si më poshtë:

PËR LOTIN 1 –BLERJE DETERGJENTË

1. **Solucion larës dyshemeje (pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm^3 - 1.1 gr/cm^3 . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
2. **Solucion larës xhamash,** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm^3 deri në 1.2 gr/cm^3 . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0 % deri në 4.0 %.
3. **Shampo antiparazitare (pedikulocid):** Përmban pyrethrin jo më pak se 0.35%, piperonil butoxide jo më pak se 2%. I ambalazhuar në shishe plastike. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
4. **Shampo për larje koke:** të ketë aftësi pastruese të zbokthit dhe zbutjes së flokut gjatë larjes. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH jo më e madhe se 6 dhe jo më e vogël se 5.5. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 15,000 cp dhe jo më i madh se 25,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se $1,025 \pm 0,025 \text{ g/ml}$. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
5. **Shampo për larje trupi:** të ketë aftësi pastruese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH jo më e madhe se 6 dhe jo më e vogël se 5.5. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 10,000 cp dhe jo më i madh se 15,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se $1,016 \pm 0,005 \text{ g/ml}$. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
6. **Sapun rrobash:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit

të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 deri në 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %. Lartësia e shkumës të jetë jo më e madhe se 5 cm.

7. **Sapun tualeti duarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %.Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.
8. **Acid për pastrim,** të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100 %.Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
9. **Solucion larës WC dezinfektues:** Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5 %.
10. **Solucion për pastrimin e smërcit/kripërave nga hidrosanitet me mekanizëm sprucimi:** Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitet. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Detergjentet klasifikohen e paketohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9108, datë 17.7. 2003 " PER SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE " dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mallrat duhet të jene të ambalazhuara si më poshtë:

- Ambalazhimi të jetë në formë të dukshme, në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.
- Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë dhe cilësisë së produktit.
- Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.
- Etiketat duhet të jene qartësisht të lexueshme dhe të kuptueshme. Te jene të shkruara rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

-
- Per solucionet “leng” ambalazhimi / paketimi te jete ne shishe/bidona/kontenier plastike.
 - Per solucionet “pluhur” ambalazhimi/ paketimi te jete ne paketim kartoni/ plastik.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit
- Pesha
- Emri i markës prodhuese (emri tregtar i produktit), adresa e plotë e kompanisë prodhuese dhe / ose tregtuese, numri i telefonit, si dhe adresa postare elektronike e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg (kur është e mundur).
- Data e prodhimit për produkte të caktuara, përveç atyre që në logon e paketimit/ ambalazhimit përcaktohet vlefshmeria për periudha 12/ 24/ 36 muaj nga momenti i hapjes për përdorim të produktit.
- Treguesit kryesor fiziko-kimik.
- Specifikimet e kërkuara (përmbajtja, sipas kushteve specifike; informacioni i nevojshëm për të dhënat e përbërësve për detergjentet, si dhe udhëzimet për përdorim dhe për etiketim).
- Etiketa e vendosur në çdo produkt të kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose e përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Në rast të ndonjë reference të mundshme në marka tregtare konkrete në këto specifikime teknike, do të pranohet ekuivalenti përkatës i artikujve.

PËR LOTIN 2 – BLERJE SOLUCION

LOTI 2

11. Solucion mizash dhe mushkonjash: Spray me ambalazhim në paketim plastik. Të jetë me aromë jo shumë të fortë.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Detergjentet klasifikohen e paktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9108, datë 17.7. 2003 " PER SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE " dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mallrat duhet të jene të ambalazuara si më poshtë:

- Ambalazhimi të jetë në formë të dukshme, në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.
- Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë dhe cilesisë së produktit.
- Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.

-
- Etiketat duhet të jene qartesisht të lexueshme dhe të kuptueshme. Te jene të shkruara rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.
 - Per solucionet “leng” ambalazhimi / paketimi te jete ne shishe/bidona/kontenier plastike.
 - Per solucionet “pluhur” ambalazhimi/ paketimi te jete ne paketim kartoni/ plastik.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit
- Pesha
- Emri i markës prodhuese (emri tregtar i produktit), adresa e plotë e kompanisë prodhuese dhe / ose tregtuese, numri i telefonit, si dhe adresa postare elektronike e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg (kur është e mundur).
- Data e prodhimit për produkte të caktuara, përvec atyre që në logon e paketimit/ ambalazhimit përcaktohet vlefshmeria për periudha 12/ 24/ 36 muaj nga momenti i hapjes për përdorim të produktit.
- Treguesit kryesor fiziko-kimik.
- Specifikimet e kërkuara (përmbajtja, sipas kushteve specifike; informacioni i nevojshëm për të dhënat e përbërësve për detergjentet, si dhe udhëzimet për përdorim dhe për etiketim).
- Etiketa e vendosur në çdo produkt të kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose e përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Në rast të ndonjë reference të mundshme në marka tregtare konkrete në këto specifikime teknike, do të pranohet ekuivalenti përkatës i artikujve.

PËR LOTIN 3 – HIPOKLORIT KALCIUMI

1. **Hipoklorit Kalciumi** : Pluhur i bardhë në gri e lehtë me erën karakteristike të klorit, i imët. Përmbajtja e klorit mbi 30%. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik. Ambalazhimi te jetë i etiketuar. Të jetë cilësorë.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Detergjentet klasifikohen e paketohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9108, datë 17.7. 2003 " PER SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE " dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mallrat duhet të jene të ambalazuara si më poshtë:

- Ambalazhimi të jetë në formë të dukshme, në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.
- Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë dhe cilesisë së produktit.

-
- Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.
 - Etiketat duhet të jene qartesisht të lexueshme dhe të kuptueshme. Te jene të shkruara rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.
 - Per solucionet “leng” ambalazhimi / paketimi te jete ne shishe/bidona/kontenier plastike.
 - Per solucionet “pluhur” ambalazhimi/ paketimi te jete ne paketim kartoni/ plastik.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit
- Pesha
- Emri i markës prodhuese (emri tregtar i produktit), adresa e plotë e kompanisë prodhuese dhe / ose tregtuese, numri i telefonit, si dhe adresa postare elektronike e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg (kur është e mundur).
- Data e prodhimit për produkte të caktuara, përvec atyre që në logon e paketimit/ ambalazhimit përcaktohet vlefshmeria për periudha 12/ 24/ 36 muaj nga momenti i hapjes për përdorim të produktit.
- Treguesit kryesor fiziko-kimik.
- Specifikimet e kërkuara (përmbajtja, sipas kushteve specifike; informacioni i nevojshëm për të dhënat e përbërësve për detergjentet, si dhe udhëzimet për përdorim dhe për etiketim).
- Etiketa e vendosur në çdo produkt të kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose e përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Në rast të ndonjë reference të mundshme në marka tregtare konkrete në këto specifikime teknike, do të pranohet ekuivalenti përkatës i artikujve.

Shtojca 6

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti 1 - Blerje detergjente

Loti 1 - BLERJE DETERGJENTË			
Nr.	Emertimi i produktit	Njësia matëse	SASIA
1	<i>Solucion larës dyshemeje(pllakash)</i>		
1.1	Solucion larës dyshemeje(pllakash) (ambalazh 1 Litër)	Copë	6000
5	<i>Solucion larës xhamash</i>		
5.1	Solucion larës xhamash (ambalazh 750 ml)	Copë	350
11	<i>Shampo antiparazitare (pedikulocid)</i>		
11.1	Shampo antiparazitare (pedikulocid) (ambalazh 500 ml)	Copë	600
13	<i>Shampo për larje koke</i>		
13.1	Shampo për larje koke (ambalazh 500 ml)	Copë	3500
14	<i>Shampo për larje trupi</i>		
14.1	Shampo për larje trupi (ambalazh 500 ml)	Copë	3500
16	<i>Sapun rrobash</i>		
16.1	Sapun rrobash (ambalazh 125 gr)	Copë	7000
17	<i>Sapun tualeti duarsh</i>		
17.3	Sapun tualeti duarsh (ambalazh 75 gr)	Copë	3400
18	<i>Acid për pastrim</i>		
18.1	Acid për pastrim (ambalazh 1 Litër)	Copë	4000
20	<i>Solucion larës WC dezinfektues</i>		
20.1	Solucion larës WC dezinfektues (ambalazh 750 ml)	Copë	2000
22	<i>Solucion për pastrimin e smercit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi</i>		
22.1	Solucion për pastrimin e smercit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi (ambalazh 750 ml)	Copë	1000

Afati i lëvrimit: 24 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër. Për minikontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër, afati i lëvrimit do të jetë brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i minikontratës.

PËR LOTIN 2 – BLERJE DEZIFEKTANT

	Loti 2 - BLERJE SOLUCION		
Nr.	Emertimi i produktit	Njësia matëse	SASIA
30	<i>Solucion mizash dhe mushkonjash spray</i>		
<i>30.1</i>	Solucion mizash dhe mushkonjash spray (ambalazh 500 ml)	Copë	200

Afati i lëvrim: 24 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër. Për minikontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër, afati i lëvrimit do të jetë brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i minikontratës.

LOTI 3 - BLERJE HIPOKLORIT KALCIUMI

	Loti 3 - BLERJE HIPOKLORIT KALCIUMI		
Nr.	Emertimi i produktit	Njësia matëse	SASIA
35	Hipoklorit Kalciumi	Kg	6500

Afati i lëvrim: 24 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër. Për minikontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër, afati i lëvrimit do të jetë brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i minikontratës.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI 1 - BLERJE DETERGJENTË

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit të parë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

-
1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit të parë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 2. Operatori ekonomik duhet të **deklarojë** nëse është prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i mallrave për artikujt objekt prokurimi. Në rast kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Autorizimi apo kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit të autorizuar.
 3. Operatori ekonomik për secilin nga produktet do të paraqesë fletë-analize të lëshuar jo më herët se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga një laborator i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.
 4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës si më poshtë:
 - ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
 - ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
 5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar.
 6. Operatori ekonomik për secilin nga mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/t.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, për artikujt e listuar si më poshtë:

Nr. Rendor sipas shtojcës nr. 6	Emertimi i produktit	Njësia matëse	Sasia e mostres
1	<i>Solucion larës dyshemeje(pllakash)</i>		
<i>1.1</i>	Solucion larës dyshemeje(pllakash) (ambalazh 1 Litër)	Copë	1
13	<i>Shampo për larje koke</i>		
<i>13.1</i>	Shampo për larje koke (ambalazh 500 ml)	Copë	1
14	<i>Shampo për larje trupi</i>		
<i>14.1</i>	Shampo për larje trupi (ambalazh 500 ml)	Copë	1
16	<i>Sapun rrobash</i>		
<i>16.1</i>	Sapun rrobash (ambalazh 125 gr)	Copë	1
18	<i>Acid për pastrim</i>		
<i>18.1</i>	Acid për pastrim (ambalazh 1 Litër)	Copë	1

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e OBP-së, në adresën *Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim.

Shënim : *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik (pika 1 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se nuk plotësohen këto kritere për të tre lotet, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2 - BLERJE SOLUCION

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit të dytë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3. Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit të dytë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik për produktin objekt të këtij loti do të paraqesë fletë-analize të lëshuar jo më herët se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga një laborator i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
 - ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
 - ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
4. Operatori ekonomik për secilin nga mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/t.

-
5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit pranë ambienteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar.

Shënim : Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik (pika 1 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se nuk plotësohen këto kritere për të tre lotet, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 3 - BLERJE HIPOKLORIT KALCIUMI

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit të tretë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3. Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit të tretë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes

të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i mallrave për artikujt objekt prokurimi. Në rast kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Autorizimi apo kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit të autorizuar.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
 - ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
 - ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
4. Operatori ekonomik për secilin nga mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/t.
5. Operatori ekonomik për produktin objekt të këtij loti do të paraqesë fletë-analize të lëshuar jo më herët se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga një laborator i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.
6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit pranë ambienteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar.

Shënim : *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se nuk plotësohen këto kriterë për të tre lotet, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

